



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit me karakter profesional "Hoteleri-  
Turizëm"  
ofruar nga  
Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar  
"Qiriazi"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Prof. Dr. Merita DOLLMA

2. Dr. Nevila ÇINAJ

Prill/2022

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin i studimit me karakter profesional "Hoteleri-Turizëm" ofruar nga**  
**Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar "Qiriazi"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Qiriazi"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Programi i studimit me karakter profesional "Hoteleri-Turizëm"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 401, datë 23.07.2019
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Program i studimit me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE / 4PAK v.a. 2020-2021
18	Numri i studentëve:	28 studentë v.a. 2020-2021 18 studentë v.a. 2021-2022
19	Komente / të tjera:	

## PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Profesional “Qirjazi” në Kodër-Kamëz, është një institucion jo publik i arsimit të lartë, i themeluar me VKM Nr.274, datë 10.05.2006 “Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jo Publike “Sevasti & Parashqevi Qirjazi”.

Në zbatim të Urdhërit Nr. 92, datë 01.03.2017 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ndryshoi statusin nga Shkolla e Lartë Universitare Private në Kolegjin Universitar “Qirjazi”

KUQ përbëhet nga katër njësi kryesore nga këto tri janë fakultete, respektivisht: Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit si edhe, Kolegji Profesional i Lartë.

Struktura akademike e KUQ i është nënshtruar ndryshimeve të herë pas herëshme. Një prej këtyre ndryshimeve është dhe hapja e Kolegjit Profesional të Lartë me Urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 339 datë 21.06.2018. Sipas urdhërit KPL përbëhej nga dy departamente:

- ✓ *Departamenti i Teknologjisë Ushqimore*
- ✓ *Departamenti i Teknologjisë së Informacionit*

Në zbatim të urdhërit të MASR Nr:451 datë 25.07.2018 për hapjen e programit profesional 2-vjeçar “Hoteleri-Turizëm” u vendos nga strukturat organizative të KPL që ky program do të zhvillohej brenda njësisë bazë të Departamentit të Teknologjisë Ushqimore. Për këtë arsye njësia kryesore tani është e emërtur me emërtimin “Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizëm”.

Programi i **Studimit me karakter profesional në “Hoteleri-Turizëm”** është program studimi me 120 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje dy vite akademike.

Programi nuk ka një numër regjistrimi nga QSHA, por dokumentacioni i vënë në dispozicion tregon se ekziston një shkresë e hartuar nga Rektori i KUQ drejtuar QSHA për paisjen me numër matricullimi të studentëve të regjistruar për vitin akademik 2021-2022.

Numri total i studentëve për vitin akademik 2021-2022 ka qenë 46 studentë.

Ky program studimi profesional i ciklit 2-vjeçar, është në proces akreditimi për herë të parë.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit me karakter profesional të ciklit 2-vjeçar në "Hoteleri-Turizëm", i ofruar nga Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit, Kolegji Profesional i Lartë, i Kolegjit Universitar "Qiriazi", në Kodër-Kamëz. Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit 2-vjeçar profesional, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet, konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive.

Vlerësimi i jashtëm bazuar tek standardet e cilësisë për këtë program studimi është fokusuar në këto fusha vlerësimi:

1. Ofrimi, organizimi dhe drejtimi i programeve të studimit me karakter profesional;
2. Struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit me karakter profesional;
3. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat;
4. Burimet për realizimin e programit të studimit dhe mbështetja e studentëve;
5. Studentët dhe mbështetja e tyre.

Në manualin e vlerësimit të BA/ASCAL, shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e Vlerësimit, i miratuar nga Bordi i Akreditimit (BA) dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) sipas të cilave procesi i vlerësimit zgjat.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL, informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit si dhe nga vizita e Grupit të vlerësimit të jashtëm në IAL.

I gjithë dokumentacioni i referuar, pasqyrohet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks.

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga koordinatori teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS dhe gjatë vizitës në institucion.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga:

**Prof. Dr. Merita Dollma**

**Dr. Nevila ÇINAJ**

Koordinator teknik e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Muhamed Prezja

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV).
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në KUQ u zhvillua më 10 Dhjetor 2021. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.

- Gjatë vizitës në Institucion, vlerësuesit e jashtëm kërkuar disa materiale shitesë që koordinatori institucional i KUQ, me anë të sistemit AMS, i vendosi në dispozicion dhe që u përdorën nga GVJ gjatë hartimit të raportit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, pa-anshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e KUQ.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Grupi i vlerësimit të jashtëm pasi mori në shqyrtim komentet e Kolegjit Universitar Qiriazi mbi draft Raportin e vlerësimit të jashtëm, paraqet komentet e mëposhtme referuar çdo çështje të trajtuar në këtë shkresë:

- GVJ vlerëson që IAL ka marrë në konsideratë sugjerimin/rekomandimin e GVJ për realizimin e një studimi tregu periodik dhe ka filluar punën për realizimin e tij.
- GVJ pranon sqarimin e IAL se Dr. Enriko Cenko nuk ka qënë drejtues i Departamentit të Teknologjise ushqimore dhe turizmit dhe kete ndryshim e kemi reflektuar ne raport.
- GVJ vlerëson që IAL ka marrë në konsideratë sugjerimin/rekomandimin e GVJ për krijimin e një stafi të qëndrueshëm në programin e studimit duke rekrutuar dy pedagogë të fushës hoteleri-restorant dhe kete ndryshim të stafit PAE e kemi reflektuar ne raport.
- GVJ vlerëson që IAL ka marrë në konsideratë sugjerimin/rekomandimin e GVJ për pasurimin e bibliotekës me botime që kanë lidhje me programin e studimit si dhe po punojnë për pasurimin e ëebsite me informacione, dokumenta dhe aktivitete të IAL.

Duke shprehur konsideratat tona për vlerësimin e draft Raportit të vlerësimit të jashtëm, shpresojme që IAL të vazhdojë punën për përsosjen e programit mësimor, konsolidimit të stafit akademik, pasurimit të bibliotekës, etj.

## Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Hoteleri-Turizëm”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Kolegji Universitar “Qirjazi” në vazhden e politikave të tij, por edhe te detyrimeve që rrjedhin nga ligji 80/2015, ka hartuar një plan të strategjisë së zhvillimit të Kolegjit Universitar “Qirjazi” për vitet 2016-2021, [ <b>Aneksi. 1_2_Plani strategjik i zhvillimit KUQ 2016-2021</b> ]. Krahas këtij dokumenti, Kolegji Profesional i Lartë ka hartuar edhe një plan strategjik zhvillimi 2017-2022. Të dy dokumentet janë të miratuara nga Senati Akademik i KUQ, [ <b>An. 2_2_Plan Strategjik i Zhvillimit të KPL 2018-2022</b> ]. GVJ-ja konstaton se Programi i Studimit me Karakter Profesional në “Hoteleri-Turizëm” është hartuar në përputhje me planin e zhvillimit strategjik jo vetëm në rang institucional por edhe në rang të njësisë kryesore siç edhe është Kolegji Profesional i Lartë. Duke marrë shkas nga periudha kohore që Plani Strategjik i Zhvillimit të KPL përfshin për tu zbatuar, konstatojmë se ky dokument është në fundin e vlefshmërisë së tij. <i>Për këtë arsye GVJ-ja sugjeron hartimin e një dokumenti të ri strategjik me qëllim që, programi i studimit me karakter profesional të mund të zhvillohet në koherencë me dinamikat e zhvillimeve në institucionet e arsimit të lartë dhe dinamikës së zhvillimit të turizmit në Shqipëri.</i> [ <b>Aneksi. 1_2_Plani strategjik i zhvillimit KUQ 2016-2021</b> ].
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statuti i KUQ [ <b>An. 1_1 Statuti KUQ</b> , rregullorja e KUQ dhe rregullorja e Kolegjit Profesional të Lartë [ <b>An. 1_3_Rregullorja e KUQ</b> ], [ <b>An. 2_3_Rregullorja e KPL</b> ] përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tyre. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit me karakter profesional në “Hoteleri-Turizëm” është në përputhje me fushat e deklaruara akademike të Kolegjit Universitar “Qirjazi”, Njësisë Kryesore dhe të vetë departamentit të TUT. [ <b>An. 2_3_Rregullorja e DTUT</b> ]. GVJ vëren se DTUT ka të përcaktuara qartë drejtimit strategjike të zhvillimit të programeve dhe fushave të studimit dhe kërkimit të cilat të jenë në përputhje me fushën e veprimtarisë së KUQ, në <b>Nenin 11 dhe 12 të Rregullores se Departamentit TUT</b> .
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.	
<b>Kriteri 4.</b> Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto	Propozimi për, hapjen e programit të studimit profesional 2-vjeçar “Hoteleri-Turizëm” në Kolegjin Profesional të Lartë është kryer e mbështetur në studimin mbi tregun e punës në nivel kombëtar para hapjes dhe gjatë zhvillimit të këtij programi. [ <b>An. 3_8 Studim tregu për HT përpara hapjes</b> ]. Gjithashtu njësia bazë DTUT ka kryer edhe

programe.	një studim të tregut të punës për vitin 2020. <b>[An. 3_9 Studim periodik tregu].</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	DTUT si njësi bazë e KPL-së, njëkohësisht si struktura që ligji 80/2015 i jep të drejtën e përgjegjësive së programeve të studimit (ndryshe nga ligji i vjetër që ja jepte këtë të drejtë Fakultetit) të kryejë një studim të përgjithshëm mbi nevojat e tregut të punës në lidhje me programet që ajo ofron (ku të përfshihet dhe programi profesional 2-vjeçar “Hoteleri-Turizëm”. Dokumentacioni i programit të studimit profesional 2-vjeçar në “Hoteleri-Turizëm” përmban një studim periodik të tregut të punës. <b>{An. 3_9 Studim periodik tregu}</b> .)  Nga shqyrtimi i përmbajtjes së tij, GVJ konstaton se studimi periodik i tregut ka të njëjtën përmbajtje me studimin e tregut përpara hapjes. Mbështetur në këtë konstatim, edhe pse programi i studimit është i ri dhe ka diplomuar vetëm një brez studentësh, <i>GVJ rekomandon kryerjen e një studimi të ri të tregut të punës për periudhën gjatë të cilës zhvillohet programi i studimit profesional 2-vjeçar.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Nga vizita në institucion, GVJ identifikoi se personeli akademik dhe drejtuesit, në mënyra të ndryshme, marrin informacione për nevojat e tregut të punës në nivel kombëtar dhe në mënyrë specifike për rajonin Tiranë-Durrës dhe i reflektojnë ato në përmbajtje të programit. Një e dhënë me shumë interes për këtë kriter na u dha në disa takime me studentët e këtij programi për format e realizimit të praktikave mësimore dhe punësimeve sezonale, por mungonin evidenca në nivel institucional nga zyra e Karrierës dhe Alumni, zyrë e cila ka për objektiv gjurmimin dhe ecurinë e studentëve në tregun e punës.  <i>GVJ rekomandon që DTUT si njësi bazë e KPL-së të kryejë një studim të përgjithshëm mbi nevojat e tregut të punës në lidhje me programet që ajo ofron (ku të përfshihet dhe programi profesional 2-vjeçar “Hoteleri-Turizëm”). Të dhënat e mbledhura nga burime të ndryshme, përfshirë edhe studentët e diplomuar, të analizohen dhe të hartohet një dokument analitik me propozime konkrete në kuadër të përmirësimit të programit të studimit (fokusi jonë është Programi profesional H-T.)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

**Kriteret**

**Vlerësimi**

<p><b>Kriteri 1.</b> Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Kolegji Universitar “Qirjazi” është një institucion jo publik i arsimit të lartë me moshë të re në të cilin, punojnë personel akademik me përvojë të konsiderueshme në ndarjen e detyrave për mbarëvajtjen e programeve dhe të programit që kemi në proces akreditimi. Sipas dokumentacionit që GVJ konsultoi, RVB-së dhe takimeve në institucion, vumë re se në ndarjen e detyrave në mbarëvajtjen e programit, Institucioni është mbështetur në Statutin dhe rregulloren e përgjithshme të KUQ, në rregulloren e KPL, rregulloren e Njësisë bazë të DTUT dhe rregulloren e programit të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ose të huaja.</p>	<p>Sikundër u theksua edhe gjatë vizitës në institucion nga drejtuesit, bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit zhvillohet në normalitet. Disa anëtarë të personelit akademik mbulojnë pozicione të ndryshme në strukturën e institucionit ose në komisione të ngritura për tematika të ndryshme . Institucioni (KUQ) në funksion të programeve të tij të studimit ka bashkëpunime me disa nga institucionet e arsimit të lartë veçanërisht me Universitete Publike dhe Jopublike vendase dhe të huaja. <b>[An. 3_10_Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese ], [RVB standardi 1.2., kriteri 1].</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Raporte analitike në funksion të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, njësia nuk harton, por këto analiza jepen në kuadrin e hartimit të raportit vjetor të KUQ (Ligji 80/2015, neni 32) . <i>GVJ mirëkupton vështirësitë që has institucioni në bashkëpunime specifike për programin Hoteleri-Turizëm, por rekomandon që të gjitha veprimtaritë që kryhen (aq sa janë deri tani, por që në të ardhmen mund të shtohen) në kuadër të realizimit të proceseve akademike dhe administrative në funksion të programit të studimit, të ruhen, administrohen, analizohen dhe raportohen në përputhje me aktet e brendshme të miratuara nga ana e institucionit dhe të publikohen edhe në ëbsite.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<b>X</b>

**Standardi I.3**

**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
-----------------	------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Grupi i ekspertëve të jashtëm, pas shqyrtimit të Dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit profesional në “Hoteleri-Turizëm”, takimeve gjatë vizitës në KUQ dhe dokumentave shtesë pas vizitës në institucion, thekson se DTUT, disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përftimin e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>GVJ, pas shqyrtimit të dosjes së vetëvlerësimit, RVB-së dhe dokumentacionit të paraqitur nga DTUT gjatë vizitës në institucion, konstatoi se programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të transferimit të krediteve (ECTS ) të cilat zhvillohen në dy vite akademike të ndara në 4 semestra.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit</p>	<p>GVJ gjithashtu, konstaton se gjendet informacioni i nevojshëm lidhur me planin mësimor, ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, mënyrën e vlerësimit të dijeve, mënyrën e frekuentimit të programit, orarin e zhvillimit të programit, etj. <b>[Plani mësimor, rregullorja e programit, rregullorja e Departamentit dhe rregullorja e programit të studimit Hoteleri-Turizëm, etj.]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka një informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit <b>[Rregullorja e FEF, rregullorja e departamentit, rregullorja e programit të studimit ]</b>.</p>
	<p>Programi i studimit profesional i ciklit 2-vjeçar në “Hoteleri-Turizëm”, ofruar nga DTUT, përmban informacion lidhur me syllabuset që zhvillon programi, ndarjen në leksione, seminare, orët brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>Syllabuset e lëndëve janë të organizuara dhe përmbajnë informacionin e nevojshëm, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi <b>[VKM Nr. 879, datë 12.18.2019]</b>. Në Syllabuse nuk jepet një përshkrim i shkurtër rreth çështjeve që do të trajtojnë tema dhe hasim të njëjtën literaturë në disa syllabuse. Për këtë arsye rekomandohet rishikimi i syllabuseve për të eliminuar përsëritjet. <i>Literatura duhet specifikuar sipas kategorisë libër, artikull apo cikël leksionesh. Rekomandohen përfshirja e lëndëve me zgjedhje që mungojnë në planin mësimor.</i></p> <p>Në kohën që po realizohet RVJ, Grupi i vlerësimit të jashtëm ka konstatuar largime të stafit (dy) nga IAL dhe nga angazhimi i tyre në mësimdhënie në programin mësimor Hoteleri-Turizëm. <i>Ky ndryshim i stafit akademik PAE ose PAK i angazhuar në mësimdhënie duhet të reflektohet edhe te titullarët e lëndëve te syllabuset si dhe të përfshihet CV dhe lista e publikimeve të tyre për të kuptuar përputhshmërinë e pregatitjes profesionale të pedagogeve me lëndën që zhvillojnë.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit vihet re se KUQ, KPL dhe njësia bazë që zhvillon programin e studimit profesional HT përmbushin kërkesat ligjore dhe e zhvillojnë këtë program studimi në përputhje me standardet e cilësisë që është vlerësuar nga akreditimi institucional, <b>{An_1_1_Aktet nënligjore për KUQ}</b>. Nga drejtuesit e institucionit u konfirmua vijimi i punës për përmbushjen e Standarteve të Cilësisë të përcaktuara nga ASCAL.</p>

të stafit akademik.	<p>Personeli akademik efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) në programin e studimit profesional “Hoteleri-Turizëm” përmbush kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga KUQ, listën e stafit akademik, planin mësimor të lidhur me stafin akademik, syllabuset e programit të studimit GVJ, shprehet si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, në këtë program studimi janë angazhuar:</p> <p>10 pedagogë efektivë të kategorisë PAE dhe 4 pedagogë me kontratë të kategorisë PAK. Referuar “Listës së personelit akademik që jep mësim në programin e studimit profesional 2-vjeçar Hoteleri-Turizëm të kategorisë PAE tri anëtarë janë me titull Prof.dr, një Prof.Asoc.Dr, një Phd, dy Dr, pesë Msc, një MA dhe një MP. Në kategorinë PAK një është Prof.As.Dr, një Dr dhe tre MSc. <b>[Dokumentacioni shtesë: 2. Lista e personelit akademik dhe CV e stafit akademik]</b></p> <p><i>Pranë stafit akademik nuk është si mbështetje asnjë personel si staf ndihmës akademik me drejtim administrativ.</i></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe RVB rezulton se program i studimit profesional “Hoteleri-Turizëm” ka të përcaktuar qartë objektivat për formimin profesional të studentëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të krijojë, të trasmetojë dhe të zhvillojë e të të mbrojë dijet përmes mësimdhënies.</li> <li>• Të përgatisë teknikë të lartë në fushën e hotelieri-turizmit për tu përshtatur me nivelin e kërkesave të kohës.</li> <li>• Të përshtaten dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal.</li> <li>• Tu mundësojë studentëve që të fitojnë njohuri teorike e praktike për strukturat akomoduese dhe minisektorët hotelier. <b>{An. 3_5_Dosja e programit HT}</b></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

## II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>

<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Programi i studimit profesional i ciklit 2-vjeçar në “Hoteleri-Turizëm”, mbështetur në shqyrtimin e dosjes se programit të studimit [An. 3_5_Dosja e Programit të studimit] përcakton si mision të tij se: <i>Transferimi i dijeve dhe njohurive bazë, të nivelit jo universitar, tek studentët, konsiston për të përgatitur teknikë të lartë në fushën e Hoteleri-Turizmit.</i></p> <p>Ndërsa si objektiva kryesor në këtë program renditen 6 objektiva, nga të cilët:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Të përgatisin teknikë të lartë në fushën e Hoteleri-2.Turizmi, për tu përshtatur me nivelin e kërkesave të kohës.</i></li> <li>3. <i>Të përshtaten dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal.</i></li> <li>4. <i>Të përgatisë një gjeneratë të re profesionistësh për strukturat akomoduese hoteliere duke ofruar cilësi në përgatitje profesionale, kulturë bashkëpunimi dhe një treg pune të garantuar.</i></li> </ol>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacion alternativat e punësimit janë: menaxherë të strukturave akomoduese, hotele apo resorte, specialistë në agjensitë turistike, specialistë në agjensitë e marketingut dhe eventeve, jo vetëm brenda por edhe jashtë Shqipërisë.</p> <p>Gjatë vizitës që GVJ zhvilloi në institucion kërkoi të dhëna reale të punësimit të studentëve që ndjekin studimet por edhe të atyre që kanë përfunduar ato.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shtesë që na u vu në dispozicion pas vizitës rezultoi se, sipas [Dok 5. Evidencë për punësimin e studentëve dhe kontaktet me studentët] 9 studentë të programit të studimit profesional HT, nga të cilët 8 studentë janë të vitit të parë dhe 1 student i vitit të dytë janë punësuar për një periudhë 88 ditore gjatë sezonit veror 2021, në Gjermani në bashkëpunim me Agjensinë e Rekrutimit SELOS. Gjithashtu në dokumentacionin shtesë gjenden komunikime zyrtare të përfaqësues së zyrës së karrierës në KUQ, në formën e emaileve, të cilat tregojnë komunikimet me studentët, nëpërmjet të cilave ata kryejnë njoftimet për ofertat e punësimit dhe praktikave mësimore nga subjekte të ndryshme që operojnë në sektorin e Hoteleri-Turizmit. Oferta janë për pozicionet kamarier, banakier, recepsionist, ndihmës kuzhinier.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p><i>Disiplinat e formimit bazë</i>, të cilat synojnë pajisjen e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për krijimin e bagazhit të duhur shkencor që përcaktojnë formimin e përgjithshëm zënë 14.5% të krediteve.</p> <p><i>Disiplinat e formimit karakterizues</i>, që synojnë sigurimin e një konteksti akademik për diskutimin e çështjeve që lidhen me nëndisiplina/nënfusha të organizimit, menaxhimit të sipërmarrjeve turistike, me synim, zhvillimin e perspektivës teoriko-praktike të studentëve edhe edukimin e kompetencave analitike për secilën lëndë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	

<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Ato plotësojnë kuadrin e njohurive teorike dhe aftësive praktike të studentëve dhe përbëjnë 55% të krediteve.</p> <p><i>Grupi i lëndëve ndërdisiplinore dhe integruese të ngjashme dhe/ose plotësuese me disiplinat karakterizuese apo profilin e programit, ato zënë 12.5% të krediteve.</i></p> <p><i>Lëndë plotësuese, synojnë të pajisin studentët me njohuri më të gjera rreth lidhjes së historisë e gjeografisë me disiplina të tjera në fushën e shoqërisë dhe mjedisit si dhe gjuhës – komunikimit dhe teknologjisë të fokusuara në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës. Lëndët plotësuese përbëjnë 14% të krediteve. Në këtë kategori bënë pjesë edhe praktika mësimore që për këtë cikël studimi luan rol parësor.</i></p> <p><i>Detyrime përmbyllëse, (4% të krediteve) lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.</i></p> <p>Shpërndarja e ngarkesës mësimore në program përcaktohet nga vetë Departamenti dhe ishte zbatuar ndarja sipas Udhëzimit të MASR për ngarkesën mësimore Nr.29, datë 10.09.2018, i ndryshuar.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit paraqiten në mënyrë të plotë kriteret dhe procedurat e ndarjes së ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë auditorit, disiplinat e formimit në këtë program, personelin akademik përgjegjës dhe infrastrukturën në dispozicion të këtij programi [An. 3_4 Rregullorja e programit HT]. Personeli akademik mbulon lëndë mësimore në fushën e tyre të kualifikimit, madje bëhen përpjekje për të patur parasysh në këtë ndarje edhe fushat e tyre të kërkimit të thelluar shkencor.</p> <p><i>Referuar të dhënave të paraqitura nga KUQ, rezultojnë se institucioni nuk ka paraqitur dokument për shpërndarjen e ngarkesës mësimore në orë dhe % që mbulohet nga PAE dhe PAK dhe sesi është e shpërndarë ajo.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.2</b></p>	
<p><b>Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Mbështetur në bazën ligjore si, Ligji Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në republikën e Shqipërisë, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.370 datë 26.04.2017, “Për organizimin dhe funksionimin dhe Kolegjit të Lartë Profesional”, KUQ ofron program studimi profesional të ciklit 2-vjeçar me emërtimin “Hoteleri-Turizëm”. Ky program ofrohet nga Departamenti i Teknologjisë Ushqimore dhe Turizmit. Për realizimin e këtij programi KUQ bashkëpunon me institucione të tjera si Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Europian Viadrina, në Frankfurt, dhe Shoqëri tregtare të fushës respektive.</p> <p>Format e organizimit të programit janë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksione</li> <li>• Seminare</li> <li>• Laborator</li> <li>• Projekt/Detyra</li> <li>• Praktika Profesionale</li> </ul> <p>Si program studimi me karakter profesional HT zhvillohet në dy vite akademike dhe në katër semestra. Programi i studimit profesional të ciklit 2-vjeçar në “Hoteleri-Turizëm”, bazuar në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, VKM Nr. 879, datë 12.18.2019 dhe në rregulloren përkatëse të programit të studimit është organizuar në leksione, seminare dhe praktikë <b>[Plani mësimor për vitin 2020-2021, An. 3_5_3 Program mësimor HT]</b>.</p> <p>Ndarja në kategori (A, B, C, D dhe në E) është në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, edhe ngarkesa në kredite (në %) përputhet plotësisht me legjislacionin në fuqi. <b>[An. 3_5_2 Kredite programi HT, An. 3_5_1 Plani mësimor ]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni shoqërues, emërtimi, struktura dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/kredite ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale.</p> <p>Studentët në këtë program studimi në auditor marrin:</p> <p>320 orë leksione; 665 orë seminare; 60 orë praktikë profesionale 50 orë provim i përgjithshëm përfundimtar</p> <p><b>Në total studentët përfitojnë 1205 orë mësimore [An_3_5_1 Plani Mësimor].</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe syllabuseve, vëmë re se fokusi i programit të studimit është përqëndruar më së shumti në marrjen e njohurive në sferën e komunikimit dhe shërbimit hotelier të përfaqësuara nga lëndë me shtrirje gjithë vjetore si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. “Komunikim dhe zhvillim aftësish në Hoteleri-Turizëm”</li> <li>2. “Ushqimi dhe të ushqyrit/ bazat e kuzhinës, bazat e shërbimit të ushqimit dhe pijeve”. <b>[An_3_5_1 Plani mësimor]</b>.</li> </ol> <p>Këto dy lëndë zënë 45% të numrit total të orëve vjetore të semestrit të parë. Ato kombinohen me lëndë interdisiplinare si Informatike në Turizëm dhe Gjuhë të huaja Anglisht dhe Gjermanisht që plotësojnë më së miri kërkesën për cilësi të burimeve njerëzore në tregun e shërbimeve turistike.</p> <p>Në vitin e dytë studentët e këtij program studimi formohen me njohuri gati të përafërta me ato të vitit të parë por me emërtime të ngjashme si, “Informatike e Aplikuar”, “Menaxhim i Sistemeve të Informacionit” dhe “Sjellje organizative”</p> <p>Referuar emërtimeve të programit të studimit “Hoteleri-Turizëm” dhe objektivave të programit të studimit ndër të cilat janë edhe përgatitja e guidave turistike dhe agentëve turistik, <i>GVJ gjykon se shpërndarja e moduleve/lëndëve nuk duhet të jetë kaq e polarizuar vetëm për shërbimin hotelier duke lënë pa trajtuar konceptet themelore në turizëm, etj.</i></p> <p>Duke mbajtur parasysh dinamikën e zhvillimit të tregut turistik në Shqipëri dhe me qëllimin që programet e studimit të jenë sa më afër kërkesave të tij <i>GVJ sygjeron përmirësimin e kurikulës ku të përfshijë lëndë si Baza Turizmi, Gjeografi e turizmit, Marketing i turizmit, E-Turizëm, Transporti dhe turizmi, etj. Një përmirësim i tillë do të shërbente studentëve të këtij programi për të forcuar kompetencat</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p><i>profesionale në përputhje me tregun e punës.</i></p> <p>Lëndët e programit të studimit që i dedikohen aftësimin në praktikë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mikpritje, Akomodim, Menaxhim eventesh në Hoteleri-Turizëm, plus lëndë praktike 1 Sem I, Viti II, 90 orë, 9 kredite;</li> <li>2. Komunikimi dhe zhvillimi i aftësive në Hoteleri-Turizëm, plus lëndë praktike 1, Sem I dhe II, Viti I, 60*2 orë, 6*2 kredite;</li> <li>3. Ushqimi dhe të ushqyerit, Bazat e kuzhinës, Bazat e shërbimit, të ushqimit dhe Pijeve, plus lëndë praktike 1, Sem I dhe II, Viti I, 75*2 orë, 7*2 kredite</li> </ol> <p>Lëndët e mësipërme zënë 320 orë nga 1205 orë Total, që në përqindje përfaqësojnë 26.5%.</p> <p>GVJ kostaton se këto lëndë përmbushin kriterin për aftësimin në punë konkrete në profesion. Ky konstatim u mbështet edhe nga studentët në takimin që u realizua me ta gjatë vizitës në institucion, të cilët na informuan se këto lëndë i zhvillonin në sisteme hoteliere të konsoliduara në qytetin e Tiranës, Birra Stela, Hotel Mondial, hotel Plaza etj. <i>GVJ vlerëson kryerjen e lëndëve praktike në punë konkrete si një prej pikave të forta të këtij program studimi.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Shpërndarja e aktiviteteve me karakter praktik dhe teorik në planin e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive dhe krijimin e kushteve të duhura për një kompetencë të nevojshme në të ardhmen, ku ata të ushtrojnë profesionin e tyre. Duke mbajtur në konsideratë se programi i studimit është me karakter profesional, GVJ konstaton se mundësinë për thellimin e njohurive në cikle të tjera studentëve e kanë studentët që sigurojnë rezultate të larta të të nxënit. Ata mund të ndjekin ciklin e parë të studimit (Bachelor), duke u thelluar në ciklin e dytë, Master Profesional ose Master i Shkencave në fusha si Biznes, Marketing, Turizëm.</p> <p><i>GVJ mendon se në kushtet e një tregu shumë të vogël që ka vendi ynë kjo mundësi është një pikë e fortë për këtë program.</i> Kjo gjë u theksua edhe në takimet që patëm me personelin akademik, por sidomos në takimin me studentët <b>[Takimi i GVJ me studentët]</b>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

**Standardi II.3**

**Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>Në dosjen e programit të studimit, në planin mësimor dhe programin mësimor të programit të studimit profesional 2-vjeçar Hoteleri-Turizëm jepet informacion i plotë rreth <b>lëndëve të formimit praktik</b> që janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mikpritje, Akomodim, Menaxhim Eventesh në hoteleri-Turizëm, plus lëndë praktike;</li> <li>2. Komunikimi dhe zhvillimi i aftësive në Hoteleri-Turizëm, plus lëndë praktike;</li> </ol>

	<p>3. Ushqimi dhe të ushqyerit, Bazat e kuzhinës, Bazat e shërbimit, të ushqimit dhe Pijeve, plus lëndë praktike; <i>[An_3_5_1_Plani mësimor]</i></p> <p><b>Lëndë të formimit teorik:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sjellje organizative dhe konsumatore</li> <li>2. Drejtim i Burimeve Njerëzore</li> <li>3. Trashëgimia natyrore dhe identiteti kombëtar</li> <li>4. Legjislacioni në HT;</li> <li>5. Menaxhim i sistemeve të informacionit në HT;</li> <li>6. Zhvillim i Guidave turistike:</li> </ol> <p><b>Aktivitete formimi;</b> Praktika Profesionale</p> <p><b>Provimi i Përgjithshëm</b> <i>[An_3_5_1_Plani mësimor]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Përbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>Nga konsultimi me dosjen e programit të studimit GVJ konstaton se, përbajtja, struktura e programit të studimit është planifikuar duke përbushur kërkesat e mëdha që tregu turistik shqiptar ka për burime njerëzore të kualifikuara në fushën e shërbimeve hoteliere, bareve, restoranteve në veçanti por edhe në lëmin e shërbimeve turistike në përgjithësi. Këto kompetenca studentët i marrin në lëndët Bazat e Shërbimit, Bazat e Kuzhinës, Bazat e Shërbimit të Ushqimit dhe Pijeve; Komunikimi dhe Zhvillimi i Aftësive në HT; Mikëpritje; Akomodim; Menaxhim eventesh. <i>[An_3_5_1_Plani mësimor]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Përbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Përbajtja e planit mësimor tregon se, lëndët që realizohen në punë konkrete pranë njësive hotel dhe restorant janë të shtrira gjatë vitit akademik çka mundëson marrjen e kompetencave profesionale në mënyrë graduale nga njëri vit akademik në tjetrin duke formësuar dhe zhvilluar tek studentët njohuri të qëndrueshme dhe praktike. <i>[An_3_5_1_Plani mësimor]</i></p> <p>Veçanërisht lëndët e formimit praktik si, Komunikimi dhe Zhvillimi i Aftësive në HT; Mikëpritje; Akomodim; Menaxhim Eventesh dhe Bazat e Shërbimit, Bazat e Kuzhinës, Bazat e Shërbimit të Ushqimit dhe Pijeve zhvillohen përgjatë gjithë ciklit të studimit. 2-vjeçar. <i>[An_3_5_1_Plani mësimor]</i></p> <p>Nga takimin me studentët, në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se metodat e mësimdhënies ishin të kombinura midis marrjes së njohurive teorike dhe aftësive praktike brenda orës së planifikuar. Kjo mundësohej falë infrastrukturës mësimore, ushtrimit praktik në laboratorin e krijuar për aplikimin e shërbimeve në hotel dhe restorant. Forma e shpërndarjes lëndore dhe fitimi i kompetencave ishte i vlerësuar nga studentët dhe kishte dhënë rezultate konkrete tek aftësimi i tyre.</p> <p><i>Ky tregues, përbën një avantazh të programit të studimit 2-vjeçar profesional në H-T në KUQ krahasuar me programe studimi të ngjashme në universitetet publike.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përftimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik,</p>	<p>Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik/praktik të programit profesional 2-vjeçar në Hoteleri-Turizëm u shërbejnë studentëve të fitojnë aftësi profesionale të nivelit të lartë në fushën shërbimeve hoteliere dhe turistike, të lidhura me kërkesat kombëtare dhe rajonale të</p>

<p>zgjdhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>tregut të punës. [An_3_5_1_Plani mësimor]</p> <p>Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/kredite ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. <i>Kjo i formon ata me kompetenca profesionale si recepcionist, barist, menaxhues salle të cilat ata i vënë në përdorim menjëherë sapo dalin në tregun e punës.</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Programi i studimit profesional 2-vjeçar në “Hoteleri-Turizëm” ka diplomuar vetëm një brez studentësh. Gjatë studimeve në këtë program studimi studentët kanë mundësinë të zhvillojnë praktikat profesionale në sistemet hoteliere e restorante në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Një pjesë e studentëve të diplomuar në brezin e parë kanë mundur të punësohen jashtë vendit. Kjo është realizuar nga nënshkrimi i kontratave të punës të siguruara nga Kolegji Universitar Qirjazi” me subjekte private brenda dhe jashtë vendit. [An_3_12_Analiza Vjetore e DTUT] dhe [vizita e GVJ në institucion me studentët] [shih Standartin II.1]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p><b>Standardi III.1</b></p>	
<p><b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Institucioni në rregulloren e KUQ dhe rregulloren e QTUT ka të përcaktuara qartë mekanizmat e vlerësimit të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies. IAL ka hartuar udhëzues të vecantë për monitorimin e cilësisë si dhe ka ngritur njesine e posacme për monitorimin e cilësisë NJSBC (Njësia e Sigurimit të brendshëm të cilësisë). Një anëtar i NJSBC është student dhe opinioni i studentëve merret në mënyrë direkte ose indirekte nëpërmjet pyetsorëve. [Rregullore e KUQ, Rregullore e NJSBC, Pyetsori i studentëve].</p> <p>IAL për këtë program mësimor është konsultuar me modele italiane dhe gjermane dhe ndjek politikën e përmirësimit apo ndryshimit brenda</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Format e mësimdhënies,</p>	



<p>mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>ligjeve dhe rregullores se KUQ në funksion të arritjes së objektivave që kërkon tregu i punës. <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik].</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Në syllabuse shprehen format e mësimdhënies që janë leksione, seminare, projekte, praktika profesionale, etj. Gjithashtu institucioni organizon leksione të hapura si dhe nxit aplikimin e teknologjisë së informacionit në mësimdhënie. <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik].</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie përfshin tre anëtarë PAE me titull Prof.dr, një Prof.Asoc.Dr, një Phd, dy Dr, pesë MSc, një MA dhe një MP. Ndërsa personeli akademik PAK përfshin një anëtar me titullin Prof.As.Dr, një Dr dhe tre MSc. Nga verifikimi i CV te stafit akademik dhe syllabuseve që ato japin, GVJ konstaton përputhje të kompetencave profesionale të stafit akademik me programin e studimit. Referuar aftësive akademike të deklaruara në CV përkatëse rezultojnë se personeli akademik zotëron kompetenca shkencore në realizimin e moduleve dhe lëndëve të programit mësimor profesional 2-vjeçar në “Hoteleri-Turizëm”.<b>[Dokumentacioni shtesë: 2. Lista e personelit akademik, CV e stafit akademik]</b> Nga takimi me studentët u evidentua se pedagogët janë të përgatitur profesionalisht dhe përdorin metoda interaktive dhe alternative në funksion të arritjes së objektivave dhe leksioneve specifike.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p><b>[Syllabuset; Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik; Përdorimi i teknologjisë së informacionit në funksion të mësimdhënies; Takimi i GVJ me studentët].</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni nxit dhe mbështet financiarisht trajnimin, kërkimin shkencor dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore të stafit akademik, nëpërmjet bashkëpunimit dhe marrëveshjeve që ka me IAL brenda dhe jashtë vendit, organizimit të konferencave dhe seminareve shkencore, financimit të pjesëmarrjes së stafit akademik dhe studentëve në aktivitete shkencore, botimin e materialeve të konferencave, etj. IAL ndjek politikën e financimit të aktiviteteve shkencore ose pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete shkencore nga Bordi i administrimit të IAL. Në listen e aktiviteteve shkencore për tre vitet e fundit shihet pjesëmarrja me kumtesa në konferenca shkencore e disa anëtarëve të stafit akademik të përfshirë në programin e studimit. Po kështu edhe botime shkencore (artikuj shkencor, libra) që tregojnë aktivizimin e vazhdueshëm të stafit akademik në aktivitete shkencore dhe botime shkencore në funksion të ngritjes profesionale dhe kualifikimit të mëtejshëm të tyre. <b>[Vendimi i Senatit për vitin 2021-2022; Aneks 1-13, Udhëzim për kualifikimin e stafit akademik; Aneks 1-16, Vendim bordi, pagesat për konferenca dhe paisje të bibliotekës; Te dhena të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik, tabela 1,2,3,4; Takimi i GVJ me stafin].</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

				X
--	--	--	--	---

### Standardi III.2

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe nga vizita ne IAL, GVJ konstatoi se IAL disponon hapësira të mjaftueshme sipas standarteve shtetërore, komode, funksionale dhe të paisura me kompjutera, projektore, wifi, etj, për realizimin me sukses të mësimin teorik dhe praktik. <b>[Infrastruktura mësimore e KUQ; Vizita ne IAL e GVJ].</b></p> <p>Të gjithë pedagogët kanë hapësirat e tyre personale të paisura me kompjutera si dhe studentët kanë hapësira të dedikuara për ata për përdorim kompjuterash, sallë leximi, biblioteken, kancelarine, etj. <b>[Vizita e GVJ ne IAL].</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuara.</p>	<p>Institucioni disponon në bibliotekën e tij një koleksion të pasur librash, përfshirë dhe libra të vjetër të trashëguar nga familja Qiriaz. Literatura është në plotësim e sipër. Në bibliotekë ka prani më të shumtë të librave për teknologjinë ushqimore. <i>Librat për turizmin dhe hotelerinë të viteve të fundit mungojnë.</i> Mungesa e literaturës bazë dhe asaj ndihmëse pengon marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme per programin e studimit. IAL po punon për aksesimin e E-library, por aktualisht nuk kanë akses. <b>[Vizita e GVJ në bibliotekë].</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>IAL disponon dy laboratore IT të paisura më kompjutera dhe kabinetin e hotelerisë për realizimin e praktikës së hotelerisë të paisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për praktikën në një anë të sallës dhe aspektit teorik në anën tjetër. E gjithë infrastruktura laboratorike dhe kompjuterike është në dispozicion të studentëve dhe përdoret nga ata. <b>[Takimi me stafin, Takimi me studentët, Vizita e GVJ në Kabinetin e hotelerisë dhe laboratore].</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Stafi përdor mësimin në auditor por në raste të nevojshme përdor edhe platforma online. Kjo sidomos pas eksperiencës së mësimin online në kohë të pandemisë. Për komunikim individual ose në grup pedagogët dhe studentët përdorin platformën Google classroom. <b>[Udhëzim për përdorimin e platformave online].</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin</p>	

e tyre.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi III.3

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	Institucioni ka ngritur pranë Rektoratit njësinë e posaçme për monitorimin e cilësisë NJSBC (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë). Një anëtar i kësaj njësie është përfaqësues i studentëve. Kjo njësi monitoron rregullisht cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet pyetsorëve për studentët dhe pedagogët. Rezultatet i raportohen Senatit, Përgjegjësit të Departamentit dhe vetë pedagogut. Kjo u konfirmua nga takimi i GVJ me anëtarët e NJSBC, Stafin akademik dhe me studentët. Cdo fund viti NJSBC harton raportin e vlerësimit të brendshëm, i cili bëhet pjesë e diskutimit në analizën vjetore të cilësisë së mësimdhënies të departamentit. <b>[Rregullore e NJSBC, Rregullore e DTUT, Pyetsori i studentëve, Takimi i GVJ me NJSBC, stafin dhe studentët].</b>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Njësia kryesore dhe ajo bazë janë përgjegjëse për procesin e mësimdhënies dhe angazhohen për rritjen e cilësisë së programit të studimit. Nga takimi me stafin rezultoi se ata janë angazhuar në përmirësimin e programit mësimor brenda 20% që ja lejon ligji për ndryshime në një vit. <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik].</b>
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	Nga takimi me studentët rezultoi se studentët nuk janë përfshirë në hartimin apo përmirësimin e programit mësimor. Ata u shprehën se programi aktual përmbush pritshmëritë e tyre. <b>[Takimi i GVJ me studentet].</b>
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit e tyre.	Ndjekja e metodave inovative nxitet dhe mbështetet institucionalisht nëpërmjet udhëzuesve të vecantë, trajnimeve të ndryshme, seminareve, ëorkshopeve dhe leksioneve të hapura. Kohët e fundit stafi është trajnuar në lidhje me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie, metodat inovative dhe kreative në mësimdhënie. Nëpërmjet pyetsorëve me studentët si dhe pyetsorit të KPL për pedagogët analizohen edhe efektet e metodave të reja të mësimdhënies. <b>[Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik; Udhëzues për përdorimin e platformave online; Te dhena të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kerkimin shkencor të stafit akademik, tabela 1,2,3,4; Përdorim i teknologjive të inovacionit në mësimdhënie; Pyetsori i KPL për stafin akademik].</b>
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për	

rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi III.4

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimin, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimin të njohurive dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e KUQ; rregulloren e KPL, rregulloren e DTUT, si dhe në syllabuset e cdo lënde. <b>[Rregullore e KUQ; Rregullore e DTUT; Rregulloren e programit të studimit Hoteleri-Turizëm, Kreu V, neni 15; Syllabuset e cdo lënde].</b>  Studentët informohen nëpërmjet syllabuseve si dhe vetë pedagogut për mënyrën e vlerësimin, e cila rezulton nga puna në projekte dhe aktivizimi, testet e ndërmjetme dhe provimi final. Për informimin dhe delegimin e problematikave të studentëve te pedagogët, Përgjegjesi i departamentit, etj, ekziston edhe tutori i programit të studimit <b>[Takimi i GVJ me studentët; Takimi i GVJ me stafin; Vendimi për emërtimin e tutorit, detyrat].</b>
<b>Kriteri 2.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testet garantojnë anonimin dhe pedagogët përpichen që studentët në teste të mund të shpërfaqin maksimumin e dijeve të tyre për lëndën. <b>[Takimi i GVJ me studentët].</b>
<b>Kriteri 3.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	Provimet ruhen për një periudhë gjashtë mujore. Njoftimi i rezultatit është individual në ruajtje të konfidencialitetit. Studentëve ju jepet kohe për rishikim dhe ankimin 24 ore pas shpalljes së rezultatit paraprak. Procedurat e provimit janë të shprehura në Rregulloren e programit, ku shprehet që provimi final bëhet me shkrim dhe me komision të përbërë nga të paktën dy anëtare të stafit akademik. <b>[Rregullore e programit të studimit Hoteleri-Turizëm, Kreu V, neni 15; Rregullore e DTUT, neni 31,33, Takimi i GVJ me studentët].</b>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin, të cilat garantojnë anonimin, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive bëhet gjatë gjithë vitit nëpërmjet

<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>testeve të ndërmjetme, aktivizimit të studentëve në seminare dhe leksione si dhe provimit final. Secili nga këto vlerësohet me pikë (të përcaktuara në cdo syllabus me %) dhe shuma e tyre nxjerr vlerësimin final. Konkretisht vlerësimi final del nga 20% aktivizimi; 10% provimet e ndërmjetme –test 1 dhe test 2 vlerësohen nga 2-5%; 60% provimi përfundimtar. <b>[Syllabuset].</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.</p>	<p>Vlerësimet realizohen nga komisione provimi që përbëhet nga pedagogu i lëndës dhe një pedagog tjetër i një disipline të përafërt. Vlerësimet ruhen në sekretarinë mësimore dhe në databazën personale të pedagogut.</p> <p><b>[Takimi i GVJ me stafin; Takimi i GVJ me studentët; Vizita e GVJ në sekretarinë mësimore; Rregullore e sekretarisë mësimore; Rregullore e KUQ].</b></p> <p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe dalin nga mbledhja e % së testeve të ndërmjetme, aktivizimit, esese ose detyrës së kursit dhe provimit final. Prania e komisioneve është në funksion të garantimit të meritës në rezultatin e kontrollit të dijeve. Nga takimi me studentët, GVJ konstatoi korrektesë të stafit akademik në vlerësimin e studentëve. Rezultatet paraprake të provimit hidhen në sistem pesë ditë nga data e provimit. Rezultatet i bëhen të ditura studentëve nga sekretaria mësimore në mënyrë individuale për të ruajtur privatësinë, ku bazuar në rregulloren e KUQ studentit i lihet një kohë 24 orësh për ankimim dhe rishikim të vlerësimit. Kjo realizohet nëpërmjet verifikimit të provimit, projektit, etj, në prezencë të studentit dhe komisionit të vlerësimit. Nëse nuk ka ankimin, shpallet rezultati përfundimtar. <b>[Vizita e GVJ në sekretarinë mësimore; Rregullore e sekretarisë mësimore; Rregullore e KUQ, neni 31; Takimi i GVJ me stafin; Takimi i GVJ me studentët].</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b></p>	
<p><b>Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit</p>	<p>Programi i studimit Hoteleri Turizëm, është i organizuar sipas</p>

<p>zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim të njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.</p>	<p>përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi. Programi i studimit synon zhvillimin e aftësive profesionale në dy fusha, hoteleri dhe turizëm.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	<p>Programi i studimit zhvillohet në dy vite akademike me 4 semestra dhe ka 120 ECTS në total. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, praktika. Lëndët me karakter të përgjithshëm dhe ato profesional ndikojnë në formimin dhe zhvillimin e aftësive të përgjithshme dhe të veçanta profesionale të studentëve për hoteleri dhe turizem. Lëndët që kanë më shumë lidhje me programin e studimit me karakter profesional në Hoteleri-Turizëm janë: Komunikimi dhe zhvillimi i aftësive në hoteleri turizem; Marketingu në hoteleri turizem; Bazat e menaxhimit në hoteleri turizëm; Mikpritje, akomodimi dhe menaxhimi i eventeve; Ushqimi dhe të ushqyerit; Trashëgimia natyrore dhe identiteti kombëtar; Zhvillimi i guidave turistike [<b>Programi i studimit, plani mësimor</b>].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikën profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin objektivave si dhe pajisjen e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit. Përfshirja e lëndëve të teknologjisë së informacionit dhe gjuhëve të huaja ndikon në aftësimin e studentëve në drejtim të përdorimit të teknologjive të informacionit si dhe komunikimit në gjuhë të huaja.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Programi i studimit ka një ndërthurje midis punës në auditor, punës individuale të studentit jashtë auditorit si dhe praktikës profesionale. Institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me hotele dhe restorante brenda vendit dhe jashtë vendit (Gjermani, Itali) për realizim të praktikave mësimore. [<b>Takimi i GVJ me studentët; Marrëveshjet e IAL</b>].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Stafi akademik mban në mënyrë të vazhdueshme shënime mbi ecurinë e studentëve, të cilat i përmbledh në fund të semestrit dhe i paraqet në mbledhjen e DTUT. Pedagogu ndjek dhe këshillon në mënyrë të vazhdueshme studentët për përmirësimin e kompetencave të tyre nëpërmjet orientimit të tyre për hulumtim literature, pjesëmarrjes në grupe pune për projekte apo detyra kursi, etj. [<b>Takimi i GVJ me stafin; Takimi i GVJ me studentët; Analizë vjetore e DTUT; Raporti i analizës vjetore të KPL</b>].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Institucioni ka të shprehur në rregulloren e tij procedurën e diplomimit të studentëve, i cili realizohet me provim. Sekretaria mësimore mban regjistër të vecantë për të diplomuarit sipas udhëzimeve të MASR. [<b>Rregullore e Sekretarisë mësimore; Rregullore e diplomimit Vizita e GVJ në sekretarinë mësimore</b>].</p>

<b>Kriteri 6.</b> Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.				
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive nga ana e tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.	Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kritere të përgjithshme dhe specifike, të cilat i shpall në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij. <b>[Statuti i KUQ]</b> .  Për rekrutimin e stafit për programin mësimor, njësia bazë harton procedura dhe kritere të përgjithshme dhe specifike, të cilat i publikon Zyra e Burimeve njerëzore. Nga vëzhgimi i dokumentacionit të stafit të brendshëm të përfshirë në programin mësimor Hoteleri Turizëm si dhe nga takimi i GVJ me Përgjegjësen e DTUT, GVJ konstatoi që ka largime dhe ndryshime të stafit, përgjegjësit të DTUT dhe koordinatorit të programit. Pedagogu Enriko Cenko, i cili rezulton të jetë larguar, është zëvendësuar me Prof.dr. Maksim Meço. <b>[Procedurat e pranimit të stafit akademik në KPL, Rregullore e zyres se Burimeve njerëzore dhe protokollit, Vizita e GVJ në Zyrën e Burimeve njerëzore]</b> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit	

<p>akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Institucioni mbledh, dokumenton dhe përditëson dosjen e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm dhe koordinatorit të programit cdo vit. Në vizitën e GVJ në Zyrën e Burimeve njerëzore nga vëzhgimi me zgjedhje rastësore të dosjes së një pedagogu të brendshëm dhe një të jashtëm, rezultoi së dosjet e tyre kishin të gjithë dokumentacionin (CV, kontratë punësimi, diploma, certifikata, certifikata trajnimesh, listë botimesh, listë të konferencave, etj). <i>Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik rezulton se personeli ka formim akademik të fushave që janë në funksion të turizmit por jo të specializuar drejtpërsëdrejti në fushën e turizmit dhe në mënyrë specifike të shërbimeve hotel-restorant.</i> Gjithashtu GVJ ka konstatuar që disa anëtarë të stafit akademik janë larguar dhe aktualisht në kohën e realizimit të RVJ nuk mund të shprehemi për përputhshmërinë e përgatitjes profesionale të pedagogut që tashmë është titullar i lëndëve me pedagogët e larguar. <b>[Vizita e GVJ në Zyrën e Burimeve njerëzore].</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Institucioni dëshmon angazhim optimal të të gjithë burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit mësimor si dhe ka krijuar kushte të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Stafi akademik ka zyra komode te paisura me paisje kompjuterike, salla leksionesh te paisura me projektor dhe kompjuter, biblioteka, kancelari, laboratore IT dhe per hoteleri për përmbushjen e detyrave të tyre akademike. Institucioni nxit dhe financon ngritjen profesionale te stafit nepermjet pjesemarrjes se tyre ne seminare trajnuese, pjesemarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit, etj. IAL ka realizuar disa herë trajnime të stafit akademik për përdorimin e platformave online dhe metodave novative të mësimdhënies. <b>[Vizita e GVJ ne IAL, Takimi i GVJ me stafin akademik].</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni angazhohet dhe nxit kualifikimin e vazhdueshëm profesional të stafit akademik nëpërmjet financimit të pjesëmarrjes së tyre në konferenca, botimit të artikujve shkencor dhe librave, pjesëmarrjes së tyre në seminare dhe ëorkshope trajnuese, etj. Raste të tilla janë seminarët ose workshopet për përvetësimin dhe përdorimin e platformave online. Foto dhe postera të këtyre trajnimeve gjendeshin ne disa salla të IAL. <b>[Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik, Te dhena të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kerkimin shkencor të stafit akademik, tabela 1,2,3,4; Takim i GVJ me stafin akademik].</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	



**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe nga vizita ne IAL, GVJ konstatoi se IAL disponon hapësira të mjaftueshme sipas standarteve shtetërore, komode, funksionale dhe të paisura me kompjutera, projektore, ëifi, etj, për realizimin me sukses të mësimit teorik dhe praktik. <b>[Infrastruktura mësimore e KUQ; Vizita ne IAL e GVJ].</b>  Të gjithë pedagogët kanë hapësirat e tyre personale të paisura me kompjutera si dhe studentët kanë hapësira të dedikuara për ata për përdorim kompjuterash, sallë leximi, biblioteken, kancelarine, etj. <b>[Vizita e GVJ ne IAL].</b>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Të gjitha auditorët janë të pajisura me projektor, kompjuter dhe ëifi dhe garantojnë realizimin e mësimit në kushte komode dhe me infrastructure informatike bashkëkohore.  IAL disponon dy laboratore IT të paisura më kompjutera për realizim detyrash, projektesh, hulumtim literature, praktikim te programeve që kane lidhje me booking, e tourism, etj, si dhe kabinetin e hotelërisë, për realizimin e praktikës së hotelërisë dhe të restorantit, të paisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për praktikat në një anë të sallës dhe aspektit teorik në anën tjetër. E gjithë infrastruktura laboratorike dhe kompjuterike është në dispozicion të studentëve dhe përdoret nga ata. <b>[Vizita e GVJ në Kabinetin e hotelërisë dhe laboratore].</b>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Institucioni me kapacitetet që zotëron (kabinetin e hotelërisë, dy salla IT), dhe në bashkëpunim me subjekte të tjera, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, garanton mjediset të mjaftueshme, të përshtatshme dhe specifike për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtari të tjera praktike thelbësore për programin profesional Hotelëri-Turizëm. <b>[Vizita e GVJ në Kabinetin e hotelërisë dhe laboratore, Marrëveshjet e IAL me hotele dhe restorante].</b>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Institucioni disponon bibliotekën dhe kancelarinë ku ndodhet edhe një sallë leximi për studentët, të cilat janë të aksesueshme për studentët gjatë gjithë kohës, ora 8-16, pa pagesë. Biblioteka dhe kancelaria janë të paisura me kompjutera dhe programe ku studentët mund të aksesojnë online literaturë në funksion të programit mësimor. Ashtu sic u shprehem me sipër studentët nuk mund të aksesojnë librarinë online për momentin. <b>[Relacion i ambienteve mësimore të KUQ, Vizitë e GVJ në IAL].</b></p> <p>Institucioni disponon në bibliotekën e tij një koleksion të pasur librash, përfshirë dhe libra të vjetër të trashëguar nga familja Qiriaz. Literatura është në plotësim e sipër. Në bibliotekë ka prani më të shumtë të librave për teknologjinë ushqimore. Gjenden disa tekste bazë dhe cikël leksionesh të disa lëndëve, por mungojnë librat për turizmin dhe hotelerinë të viteve të fundit në gjuhën shqipë dhe të huaj. Pavarësisht se IAL po angazhohet për pasurimin e bibliotekës në tërësi me mënyra të ndryshme (dhurime, fonde vjetore për blerje librash), <i>IAL duhet të plotësojë numrin e librave bazë dhe literaturës të viteve të fundit, në gjuhën shqipe dhe të huaj, për programin mësimor Hoteleri –Turizëm.</i> IAL po punon për të siguruar e- library (bibliotekën online) ku studentët të kenë akses të literaturës online. <b>[Vizita e GVJ në bibliotekë].</b></p> <p>Institucioni garanton dhe mundëson përdorimin e të gjithë logjistikës së vetë IAL dhe të institucioneve /bizneseve partnere për formimin teorik dhe praktik të studentëve. <b>[Takim i GVJ me Përgjegjesen e Departamentit, Takim i GVJ me studentët, Vizitë e GVJ në IAL].</b></p> <p>Në bazë të planit buxhetor 2018-2025 është hartuar plani financiar për programin mësimor Hoteleri – Turizëm për një cikël të plotë studimi, i cili garanton mbulimin financiar të të gjitha veprimtarive që lidhen me realizimin e programit mësimor. Në vitin 2019-2020 është financuar ngritja e kabinetit të hotelarisë.</p> <p>Bordi i administrimit merret me mbikëqyrjen e burimeve të financimit dhe shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarisë së tij. Burimi kryesor i të ardhuravë për programin mësimor janë të ardhurat nga pagesat vjetore të studentëve <b>[Plani</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe</p>	

profesional të studentëve.	<b>buxhetor 2018-2025 i IAL, Plani financiar i programit mësimor Hoteleri –Turizëm].</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.				
<b>Kriteri 6.</b> Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep informacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kritere të qarta, të përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve, përparimin dhe vlerësimin e tyre dhe të diplomimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e KUQ dhe i bën publike në ëbesite të IAL si dhe në rrjetet sociale të KPL. Kriteret hartohen në përputhje me udhëzimin e MASR Nr. 10, dt. 15.05.2019 për programin e studimit me karakter profesional, Rregulloren e KUQ, si dhe kritere të pranimit të studentëve në KPL. Bazuar në udhëzimet e përvitshme të MASR, njësia bazë harton edhe kritere specifike për programin e studimit me karakter profesional. [Ligji 80/2015, Udhëzim i MASR Nr. 10, dt. 15.05.2019, Rregullore e KUQ, Kriteret e pranimit të studentëve në KPL, Rregullore e diplomimit].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe	Politikat dhe procedurat e pranimit, frekuentimit deri në përfundim të programit mësimor garantojnë barazinë për të gjithë kandidatët dhe

<p>përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>studentët. Kriteret dhe procedurat e pranimit të kandidatëve për studentë janë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga MASR. Kriteret e pranimit dhe të vlerësimit të studentëve si dhe numri i kuotave publikohen online në ëbsite të institucionit. IAL nëpërmjet takimeve me shkollat e mesme, fletëpalosjet, ëbsite, etj, informon kandidatët për studentë për kriteret e pranimit në këtë program studimi [Statuti i KUQ, Rregullore e KUQ, Rregullore e DTUT, Rregullore e KPL, Kreu IV, V, IX].</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Departamenti nëpërmjet përgjegjesit të DTUT, stafit akademik dhe koordinatorit të programit mësimor informon në takime me studentët dhe publikon strukturën, organizimin, kohezgjatjen e programit të studimeve, praktikën mësimore, etj., si dhe mbështetjen institucionale për tregun e punës në lidhje me këtë program. [Takimi i GVJ me Përgjegjës të DTUT, stafin akademik dhe studentët].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni nëpërmet stafit akademik dhe sekretarisë mësimore informon për procedurat e diplomës. GVJ konstatoi se studentët ishin të mirë informuar për të gjitha procedurat [Takimi me studentët, Rregullore e diplomes].</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Institucioni ka përgatitur fletëpalosje, të cilat i përditëson dhe shpërndan për informim të studentëve si në ëbsite (rubrika njoftime), rrjete sociale të KPL ashtu edhe në standat e dedikuara për informim të studentëve në hollet e IAL. Megjithatë, informacioni për programin mësimor Hoteleri Turizëm (CV i stafit akademik, syllabuset, plani mësimor, etj..) mungojnë në ëbsite të IAL. [Takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët, ëbsite i IAL, fletëpalosje].</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi IV.5**

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>Zyra përgjegjëse për administrimin dhe shpërndarjen e informacionit në KPL është Sekretaria mësimore, e cila ruan në hard copy dhe në formë elektronike të gjithë databazën lidhur me regjistrimin, frekuentimin, vlerësimin, diplomimin, etj., të studentëve.</p> <p>Zyra e Burimeve njerëzore, protokollit dhe arkivit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. <b>[Rregullore e Zyrës së burimeve njerëzore, protokollit dhe arkivit, Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkepunuese, Vizitë e GVJ në Zyrën e burimeve njerëzore].</b></p> <p>IAL disponon sistemin informatik të brendshëm ku studentët dhe stafi akademik informohen për rezultatet e provimeve dhe informacione të tjera për programin e studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ nuk ka akses në sistemin e brendshëm informatik dhe nuk mund të shprehet për informacionin që përmban dhe shpërndahet studentëve dhe pedagogëve. <b>[Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore, takim i GVJ me studentët dhe stafin akademik].</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në website të IAL mungon informacioni i detajuar për programin e studimit Hotelieri-Turizëm, CV të personelit akademik, syllabuset, etj, në dy gjuhë (shqip dhe anglisht). Ndërsa informacione për aktivitete gjenden, por janë shumë të pakta. <i>Sugjerojmë përditësimin dhe pasurimin e websitë në mënyrë të vazhdueshme me informacione si për programin mësimor, stafin akademik ashtu edhe për aktivitetet shkencore dhe sociale [Website i IAL].</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>				
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e KUQ dhe rregulloren e Kolegjit profesional të Lartë [Udhëzim i MASR Nr. 10, dt. 15.05.2019, Rregullore e KUQ]. Procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik fillojnë me regjistrimin e studentit në KUQ pas shpalljes së tij fitues, frekuentimin e lëndëve në dy vite së bashku me praktikën mësimore, duke grumbulluar kreditet e nevojshme (120 ECTC) dhe konkludon me marrjen e diplomës pas mbrojtjes me provim [Ligji 80/2015, Udhëzim i MASR Nr. 10, dt. 15.05.2019, Rregullore e KUQ, Kriteret e pranimit të studentëve në KPL, Rregullore e sekretarisë mësimore].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e pranimit, frekuentimit deri në përfundim të programit mësimor garantojnë barazinë për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët. Përzgjedhja e kandidatëve fitues bëhet në varësi të renditjes së studentëve në listat e raundeve të shpallura nga MASR. Të drejtat e kandidatëve dhe studentëve garantoohen në statutin e IAL si dhe në rregulloren e KUQ [Statuti i KUQ, Rregullore e KUQ, Rregullore e DTUT].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e pranimit të kandidatëve për studentë janë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga MASR. IAL cdo fillim viti ngre komision të posaçëm për pranimin dhe regjistrimin e studentëve dhe ndjek procedurat për transferimin e studentëve dhe njohjes së studimeve të mëparshme sipas udhëzimeve të MASR dhe sipas rregullores së KPL [Rregullore e KPL, Kreu IV, V, IX]. IAL nëpërmjet takimeve me maturantët, fletëpalosjet, website, etj, informon kandidatët për studentë për kriteret e pranimit në këtë program studimi si dhe tregun e punës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Kriteret e pranimit dhe të vlerësimit të studentëve si dhe numri i kuotave publikohen online në ëbsite të institucionit. IAL harton kriteret të përgjithshme dhe të veçanta në përputhje me aktet ligjore të MASR dhe maturën shtetërore. Kriter pranimi është nota mesatare, që</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e</p>	

<p>procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>përcaktohet nga MASR si dhe numri i kuotave që përcaktohet nga institucioni në përputhje me udhëzimet e MASR. Kandidatët për studentë mund të jenë shqiptarë dhe të huaj, që plotësojnë kriterin e mesatares si dhe kanë bërë ekuivalentimin e shkollës së mesme në MASR, nëse e kanë kryer jashtë Shqipërisë. GVJ, nga verifikimi i dosjeve të studentëve gjeti të gjithë dokumentacionin që vërteton sa më sipër [Statuti i KUQ, Rregullore e KPL, Kreu IV, V, IX, Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore].</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Stafi akademik dhe Departamenti informon në takime me studentët dhe publikon syllabusin e çdo lënde ku janë të përcaktuar kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Nga takimi me studentët, GVJ konstatoi se studentët informohen nga pedagogët për mënyrën e vlerësimit që në fillim të lëndës e përgjatë semestrit deri në fund. Në ëbsite mungojnë syllabuset. [Syllabuset, Takimi i GVJ me studentët].</p> <p>Intitucioni nëpërmet stafit akademik dhe sekretarisë mësimore informon për procedurat e diplomës. GVJ konstatoi se studentët ishin të mirë informuar për të gjitha procedurat [Takimi me studentët, Rregullore e diplomes].</p> <p>Përpara çdo viti akademik, DTUT dhe institucioni, janë të angazhuar për informimin e publikut nëpërmet inisiativave të tyre të marketingut, takimeve me maturantët, fletëpalosjet, ëbsite të IAL, etj. [Takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët, Website i IAL].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>Institucioni informon studentët në takimet e hapura me studentët për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen dhe kreditet e programit të studimit. Në funksion të informimit të tyre shërbën <i>Zyra e marrëdhënieve më jashtë, pranim dhe këshillim në karriere</i> si dhe takimet e hapura në fillim viti me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore. Në këto takime në fillim viti dhe përgjatë vitit studentët informohen për programin mësimor, syllabuset, praktikën mësimore, kërkesat e tregut dhe mundësitë e punësimit. [Takimi i GVJ me stafin akademik dhe studentët].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon</p>	

<p>studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet DTUT, stafit akademik, koordinorit të programit mësimor, tutorit dhe sekretarisë mësimore informon studentët në takimet e hapura për praktikën mësimore, mënyrën e realizimit, drejtuesit e praktikës mësimore, vendet e realizimit të praktikës mësimore, marrëveshjet që ka institucioni për realizimin e praktikave brenda dhe jashtë vendit, etj.. Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se studentët ishin të mirëinformuar për praktikën mësimore dhe marrëveshjet institucionale për praktikën. <b>[Takimi i GVJ me studentët].</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet Departamentit, stafit akademik, sekretarisë mësimore, bibliotekës dhe kancelarisë informon studenët hollësisht për infrastrukturën, logjistikën dhe të gjitha shërbimet mbështetëse në funksion të realizimit të programit studimor. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të përditësuar mbi zhvillimin e procesit mësimor, ose zëvendësimin e orëve të mësimimit në raste të veçanta, duke shfrytëzuar stendat informuese por edhe nëpërmjet ëbsite dhe rrjeteve sociale të KPL. Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se studentët ishin të mirëinformuar për infrastrukturën, shërbimet, logjistikën, etj. <b>[Takimi i GVJ me studentët].</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit informatik të institucionit, stendave në hollet e Institucionit (plani mësimor, oraret, datat e provimeve, postera konferencash, seminaresh, etj). GVJ nuk ka akses të informacionit që shpërndahet nëpërmjet sistemit informatik të institucionit dhe nuk mund të shprehet nëse studentët në distance kanë qasje në informacion. Në ëbsite të IAL informacioni i detajuar për programin mësimor mungon. Në përgjithësi ëbsite i IAL është i varfër me informacione. Mungojnë programi i studimit, plani mësimor, syllabuset shqip dhe anglisht, CV e stafit, etj. <i>Rekomandohet pasurimi i ëbsite me informacione për programin e studimit, vënia e syllabuseve, CV e stafit akademik, alumni, etj.</i> <b>[Vizita e GVJ ne institucion, infrastruktura mësimore].</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi V.3**

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit e studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe</p>	<p>Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e</p>



mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. GVJ pasi verifikoi regjistrin e regjistrimit të studentëve, regjistrin e notave të studentevë si dhe tabelat përmbledhëse të raportit të analizës			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	mësimore vjetore konstatoi korrektesë në mbajtjen dhe regjistrimin e këtyre të dhënave <b>[Vizitë e GVJ në sekretarinë mësimore]</b> .  GVJ pasi verifikoi regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e notave dhe regjistrin e diplomimit të studentëve si dhe tabelat përmbledhëse konstatoi se Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, numrin e studentëve të tërhequr nga programi apo largimet para përfundimit të programit <b>[Vizitë e GVJ në sekretarinë mësimore, Raporti i analizës së punës vjetore të KPL 2019-2020, Analizë vjetore e DTUT 2019-2020]</b> .			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventual të tyre.	Institucioni disponon të dhëna të detajuara për ecurinë e studentëve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto GVJ i konstatoi nga verifikimi i regjistrave dhe dosjeve personale të studentëve në sekretarinë mësimore. <b>[Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore, Rregullore e diplomimit]</b> .			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit nëpërmjet shkrimit me dorë në regjistra dhe në formë elektronike. Veprimet lidhur me të dhënat personale të studentëve kryen bazuar në parimin e konfidencialitetit, i garantuar në statutin e IAL. <b>[Statuti i KUQ, Rregullore per ruajtjen dhe arkivimin e informacionit]</b> .			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre regjesve.	Institucioni harton raportin vjetor, bazuar në raportet e njëjësive bazë, pjesë përbërëse e të cilit është edhe analiza e cilësisë në hyrje dhe në dalje të studentit që frekuenton programin mësimor. Në takimin me stafin akademik, përfaqësues të zyrës së karrierës u shprehën se janë në kontakt me studentët e diplomuar, një pjesë e të cilëve janë të punësuar në profesion. Institucioni po punon për krijimin e rrjetit alumni. <b>[Raporti vjetor i KUQ 2019-2020, Takim i GVJ me stafin akademik, studentët dhe përfaqësues të Zyrës së marrëdhënies me jashtë, pranimit dhe këshillim në karriere]</b> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

#### Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

#### Kriteret

#### Vlerësimi

**Kriteri 1.** Institucioni parashikon

Institucioni, në statutin dhe rregulloren e tij të brendshme dhe në

<p>përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>përputhje me aktet ligjore të IAL-së, parashikon përfshirjen e studentëve në organet vendimmarrëse. Sipas statutit të KUQ, një anëtar i Senatit akademik është student. <b>[Statuti i KUQ, neni 9/2, 23/3, 51/1b]</b>. Po kështu në NJSBC dhe Këshillin e etikës një anëtar është student. Me nxitjen dhe mbështetjen institucionale studentët kanë zgjedhur Këshillin Studentor, Forumin ekonomik studentor dhe Klubin letrar.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Pjesëmarrja dhe roli i studentëve është shumë i rëndësishëm edhe në plotësimin dhe analizimin e pyetësorëve për cilësinë e mësimdhënies. GVJ nga takimi me studentët konstatoi se studentët ndihen pjesë në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim të procesit akademik. Në takimin me stafin akademik u theksua shpesh që në KPL dëgjohet shumë fjala dhe mendimi i studentëve. <b>[Ligji 80/2015, Statuti i KUQ, Takimi i GVJ me student dhe stafin akademik]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ, nga takimi me stafin akademik dhe me studentët konstatoi se përmirësimi i programit nga ana e stafit lidhur me kërkesat e tregut ka ende hapësirë për përmirësim <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik, takimi me studentët]</b>. Institucioni realizon plotësimin e pyetësorëve me studentët para përfundimit të çdo lënde dhe rezultatet e pyetësorëve i reflekton në raportin dhe analizën vjetore të departamentit. Kjo është një mënyrë indirekte e përfshirjes së opinionit të studentëve për përmirësimin e programit mësimor. <i>Megjithatë, nga takimi me studentët, GVJ konstatoi se studentët nuk janë të përfshirë drejtëpërdrejtë në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit mësimor</i> <b>[Takimi i GVJ me studentët]</b>. Institucioni duhet të punojë për përfshirjen e rregullt të studentëve në hartimin dhe rishikimin e programit të studimit duke gjetur mënyra dhe instrumenta të tjerë (përveç pyetësorëve) që kontributi i tyre të jetë konkret, i matshëm dhe efektiv.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Rregullorja e brendshme e IAL garanton se studentët kanë mundësinë e informimit dhe ankimimit mbi ndershmërinë e vlerësimin të kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e rishikimit nga ana e pedagogut <b>[Rregullore e KPL, Rregullore e DTUT]</b>. Studentëve u jepet gjithashtu mundësia e dhënies së opinionit të tyre nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve në mënyrë anonime <b>[Takimi i GVJ me studentët]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja e brendshme e IAL garanton se studentët kanë mundësinë e informimit dhe ankimimit mbi ndershmërinë e vlerësimin të kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e rishikimit nga ana e pedagogut <b>[Rregullore e KPL, Rregullore e DTUT]</b>. Studentëve u jepet gjithashtu mundësia e dhënies së opinionit të tyre nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve në mënyrë anonime <b>[Takimi i GVJ me studentët]</b>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

**Standardi V.5**

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

Kriteret	Vlerësimi			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka të ngritur një sistem të posaçëm dhe funksional për informimin, këshillimin dhe asistimin e studentëve. <i>Zyra e marrëdhënieve më jashtë, pranim dhe këshillim në karriere, tutori për programin mësimor dhe sekretaria mësimore</i> janë në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL. <b>[Statuti i KUQ, rregullore e KUQ].</b>			
<b>Kriteri 2.</b> Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në statutin e KUQ është përcaktuar procedura e informimit të studentit. Tutori ose koordinatori për marrëdhënie me studentin është anëtar i stafit akademik i njësisë bazë, i cili koordinon marrëdhëniet e Departamentit me studentët. Tutori kryen promovimin e programit të studimit të ofruar nga njësi bazë, informon, orienton dhe këshillon studentët për veprimtarinë mësimore dhe aktivitete të tjera. Ai ofron këshillim për zhvillimin e karrierës në njësinë bazë. Ai këshillon studentët për problematika të ndryshme dhe raporton problematikat e tyre në departament <b>[Statuti i KUQ, Vendimi për emrimin e tutorit].</b>			
<b>Kriteri 3.</b> Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nëpërmjet Zyrës së marrëdhënieve më jashtë, pranim dhe këshillim në karriere, institucioni ju ofron studentëve shërbimin e këshillimit në mënyrë periodike. Kjo zyrë në rregulloren e saj ka të përcaktuar misionin, vizion dhe veprimtarinë e saj për informimin e studentëve, realizimin e praktikave profesionale, këshillim karriere, informim për tregun e punës, oferta punësimi, etj. Kjo zyrë po krijon dhe pasuron databazë për studentët alumni, punësimin e tyre në profilin e programit mësimor, etj. <i>Në ëeb-site të IAL nuk ka të dhëna për studentët alumni.</i> <b>[Rregullore e Zyrës së marrëdhënieve me jashtë, pranim dhe këshillim në karriere, Takimi me studentët].</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Hoteleri-Turizëm” ofruar nga Institucioni të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Qiriazhi”**

**Pikat e forta dhe afirmime**



1. Ambiente komode me infrastrukture mësimore dhe informatike bashkëkohore
2. Numër studentësh në rritje në programin mësimor Hoteleri-Turizëm
3. Marrëveshjet me Travelbest SRL; Agjencia SELOS (Itali, Gjermani) për realizimin e praktikave mësimore me biznese jashtë vendit, të vlerësuara si ndër pikat më të forta të këtij programi nga studentët.
4. Përfshirje e studentëve në vendimarrje dhe prezencë e fortë e opinionit të tyre për cilësinë e mësimdhënies
5. Shpërndarja e aktiviteteve me karakter praktik dhe teorik në planin e programit të studimit i shërben studentëve për thellimin e njohurive dhe krijimin e kushteve të duhura për një kompetencë të nevojshme në të ardhmen.
6. Metodatat e kombinuara të mësimdhënies për marrjen e njohurive teorike dhe aftësive praktike brenda orës së planifikuar si dhe infrastrukura mësimore e IAL, që mundëson ushtrimin e praktikës profesionale në laboratorin e hotelerisë.

**Pika të dobta**

1. Staf akademik i brendshëm jo i qëndrueshëm në DTUT
2. Numër minimal tekstesh në gjuhën shqipe dhe të huaj, botime të fundit për hoteleri dhe turizëm.
3. Website i IAL i varfër me informacione për programin e studimit. Mungojnë syllabuset shqip dhe anglisht, CV e stafit akademik, studentët alumni, etj.
4. IAL nuk ka akses në E-library

**Rekomandime**

1. Rekomandohet krijimi i një stafi akademik të brendshëm të qëndrueshëm në DTUT (pesë veta) në fushën e hoteleri-turizmit si dhe e një stafi akademik të qëndrueshëm që angazhohet në programin mësimor Hoteleri-Turizëm.
2. Rekomandohet standartizimi i CV të stafit akademik sipas formatit Europass.
3. Rekomandohet që ndryshimi i stafit akademik PAE ose PAK i angazhuar në mësimdhënie të reflektohet edhe te titullarët e lëndëve të syllabuset si dhe të përfshihet CV dhe lista e publikimeve të tyre për të kuptuar përputhshmërinë e përgatitjes profesionale të pedagogëve me lëndën që zhvillojnë.
4. Rekomandohet rishikimi i literaturës të syllabuset, ku të specifikohet kategoria libër, artikull apo cikël leksionesh si dhe të mënjanohet përsëritja e të njëjtave literatura në syllabuse të ndryshme.



5. Rekomandohet përfshirja e lëndëve me zgjedhje në programin mësimor.
6. Rekomandohet pasurimi i bibliotekës me literaturë në gjuhë shqipe dhe të huaj, të viteve të fundit, për hoteleri dhe turizëm si dhe aksesimi në E library.
7. Rekomandohet pasurimi i website me informacione për programin e studimit, vënia e syllabuseve shqip dhe anglisht, CV e stafit akademik, studentët alumni, etj.
8. Rekomandohet përmirësimi i kurikulës së programit duke përfshirë lëndë për fushën e turizmit si; Baza Turizmi, Gjeografi e turizmit, Marketing i turizmit, E-turizëm, Transporti dhe turizmi, etj..
9. Rekomandohet, që të gjitha veprimtaritë që kryhen në kuadër të realizimit të proceseve akademike dhe administrative në funksion të programit të studimit, të ruhen, të administrohen, të analizohen dhe të raportohen në përputhje me aktet e brendshme të miratuara nga ana e institucionit dhe të publikohen edhe në ëbsite.
10. Rekomandohet caktimi i një personeli si staf ndihmës akademik me drejtim administrativ pranë stafit akademik sipas përcaktimeve që jep Ligji për Arsimin e Lartë në RSH.
11. Rekomandohet kryerja e një studimi periodik të tregut të punës për periudhën gjatë të cilës zhvillohet programi i studimit profesional 2-vjeçar.

**Conclusions of the Evaluation of the professional character study program "Hotel-Tourism" offered by the Institution of Higher Education "Qiriazi University College".**

**Strengths and affirmations**

1. Comfortable environment with modern teaching and IT infrastructure
2. Increasing number of students in the Hospitality-Tourism curriculum
3. Agreements with Travelbest SRL; SELOS Agency (Italy, Germany) for the realization of teaching internships with businesses abroad, evaluated as one of the strongest points of this program by students.
4. Involvement of students in decision-making and strong presence of their opinion on the quality of teaching
5. The distribution of practical and theoretical activities in the study program plan serves students to deepen knowledge and create the right conditions for a necessary competence in the future.
6. Combined teaching methods for obtaining theoretical knowledge and practical skills within the planned class as well as the teaching infrastructure of the HEI, which enables the practice of professional practice in the hotel laboratory.



**Weaknesses**

1. Non-permanent internal academic staff at DTUT

2. Minimum number of texts in Albanian and foreign languages, recent publications on hotel and tourism.
3. Website of the HEI poor with information about the study program. Albanian and English syllabi are missing, CV of academic staff, alumni students, etc.
4. HEI does not have access to the E-library.

### **Recommendation**

1. It is recommended to create a stable internal academic staff in DTUT (five people) in the field of hotel-tourism as well as a stable academic staff that engages in the curriculum Hotel-Tourism.
2. It is recommended to standardize the CV of the academic staff according to the Europass format.
3. It is recommended that the change of academic staff PAE or PWD engaged in teaching should be reflected in the course titles in the syllabi and to include the CV and the list of their publications to understand the compatibility of professional training of teachers with the subject they develop.
4. It is recommended to review the literature on syllabi, specifying the category of book, article or cycle of lectures and to avoid repetition of the same literature in different syllabi.
5. It is recommended to include elective courses in the curriculum.
6. It is recommended to enrich the library with literature in Albanian and foreign languages, of recent years, for hotel and tourism as well as access to the E library.
7. It is recommended to enrich the website with information about the study program, putting Albanian and English syllabi, CV of the academic staff, alumni students, etc.
8. It is recommended to improve the curriculum of the program, including subjects in the field of tourism such as; Basics Tourism, Geography of tourism, Marketing of tourism, E-tourism, Transport and tourism, etc.
9. It is recommended that all activities carried out in the framework of the implementation of academic and administrative processes in function of the study program, be stored, administered, analyzed and reported in accordance with internal acts approved by the institution and also be published on the website.
10. It is recommended to appoint a staff as academic support staff with administrative direction to the academic staff according to the definitions provided by the Law on Higher Education in the Republic of Albania.
11. It is recommended to conduct a periodic labor market study for the period during which the 2-year professional study program is developed.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

